



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.82

6 korrik

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

| | | |
|--------------------------------|--|------|
| Ligj nr.9757 datë 21.6.2007 | Për ratifikimin e “Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE) për sigurimin e mbështetjes së shtetit pritës, për realizimin e stërvitjeve të bashkëpunimit LONGBOW dhe LANCER, 2007” ... | 2399 |
| Ligj nr.9758 datë 21.6.2007 | Për ratifikimin e “Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për marrëveshjen e kredisë ndërmjet Autoritetit Portual Durrës dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për financimin e projektit “Ndërtimi i terminalit të trageteve dhe i shesheve përreth në portin e Durrësit” | 2407 |
| Ligj nr.9759 datë 21.6.2007 | Për ratifikimin e “Marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për programin e fazës së parë të huasë, në mbështetje të politikave të zhvillimit” | 2419 |

LIGJ
Nr.9757, datë 21.6.2007

**PËR RATIFIKIMIN E “MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMANDËS SUPREME TË
FORCAVE TË ALEANCËS NË EUROPË (SHAPE) PËR SIGURIMIN E MBËSHTETJES SË
SHTETIT PRITËS, PËR REALIZIMIN E STËRVITJEVE TË BASHKËPUNIMIT LONGBOW
DHE LANCER, 2007”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE) për sigurimin e mbështetjes së shtetit pritës, për realizimin e stërvitjeve të bashkëpunimit LONGBOW dhe LANCER, 2007”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5378, datë 26.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMANDËS
SUPREME TË FORCAVE TË ALEANCËS NË EUROPË (SHAPE) NË LIDHJE ME SIGURIMIN E
MBËSHTETJES SË SHTETIT PRITËS PËR REALIZIMIN E STËRVITJEVE TË BASHKËPUNIMIT
LONGBOW 2007 DHE LANCER 2007

HYRJE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komanda Supreme e Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE), këtu e tutje të quajtura Palë,

- *duke pasur parasysh* dispozitat e Traktatit të Atlantikut të Veriut, të datës 4 prill 1949, dhe në veçanti nenin 3 të saj;

- *duke pasur parasysh* Dokumentin Kuadër të Partneritetit për Paqe të lëshuar prej kryetarëve të shteteve dhe qeverive pjesëmarrëse në takimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut (Dokumentit Kuadër), të 10 janarit 1994;

- *duke pasur parasysh* dispozitat e Marrëveshjes midis Shteteve Palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (PfP SOFA) të datës 19 qershor 1951, përfshirë edhe Protokollin Shtesë të kësaj Marrëveshjeje, të datës 19 qershor 1995;

- *duke pasur parasysh* dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet palëve pjesëmarrëse në Traktatin e Atlantikut të Veriut në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (NATO SOFA), të datës 19 qershor 1951;

- *duke pasur parasysh* dispozitat e Protokollit mbi Statusin e Shtabeve Ushtarake Ndërkombëtare, hartuar në vijim të Traktatit të Atlantikut të Veriut (Protokolli i Parisit) të datës 28 gusht

1952;

- *duke pasur parasysh* dispozitat e Protokollit të Mëtejshëm Shtesë mbi Marrëveshjen midis Shteteve Anëtare të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse në Pfp SOFA (Protokoll i Mëtejshëm Shtesë) i datës 19 dhjetor 1997;

- *duke pasur parasysh* konceptin e shpërndarjes së forcave të NATO-s dhe forcave të koalicionit nën komandën dhe kontrollin e NATO-s në ose përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim planifikimin dhe realizimin e stërvitjeve COLW07 dhe COLR07;

- *duke pasur parasysh* konceptin e stërvitjeve dhe operacioneve të parashikuara që të zhvillohen me NATO-n, Pfp dhe forca të tjera të udhëhequra nga NATO-ja;

- *dhe duke marrë në konsideratë* nevojat e Republikës së Shqipërisë, e cila këtu e tutje quhet vendi pritës dhe nevojat e SHAPE, HQ SACT, këtu e tutje referuar si Komanda Strategjike, Palët kanë arritur në mirëkuptimin e mëposhtëm:

SEKSIONI 1 PËRCAKTIME

Për qëllim të këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe dokumenteve të tij plotësuese, aplikohen përcaktimet e mëposhtme:

1.1 Forcat: Të gjithë komponentët e forcave të udhëhequra nga NATO, përfshirë këtu edhe të gjithë personelin, kafshët, materialet dhe ushqimet, bashkë me përbërësit civilë të këtyre forcave, siç është përcaktuar në NATO SOFA, Protokollin e Parisit dhe homologët e Pfp-së. Forcat e udhëhequra nga NATO gjithashtu përfshijnë çdo forcë ose personel prej vendeve të Dialogut të Mesdheut, si dhe vendet e Iniciativës së Bashkëpunimit të Stambollit. Përcaktimi gjithashtu përfshin të gjitha anijet, avionët, automjetet, pajisjet, furnizimet, rezervat dhe armatimet, si dhe të gjitha burimet e lëvizjeve detare e ajrore, së bashku me shërbimet e tyre mbështetëse, përfshirë dhe kontraktuesit shpërndarës ose mbështetës të forcave.

1.2 Operacionet e NATO-s: Veprimet ushtarake që përmbajnë stërvitje apo misione ushtarake strategjike, taktike, shërbimi, trajnuese, të zhvilluara nga forcat; procesin e zhvillimit të luftimit, përfshirë sulmin, lëvizjen, furnizimin dhe manovrat e nevojshme për arritjen e objektivave të çdo beteje ose fushate.

1.3 Komandanti i NATO-s: Komandant ushtarak në hallkat komanduese të NATO-s.

1.4 Organizatat e NATO-s: Shtabe dhe njësi forcash të organizuara nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.5 Shtabet ushtarake ndërkombëtare: Shtabet ushtarake ndërkombëtare në strukturat përbërëse komanduese të NATO-s.

Këtu përfshihen dhe ekipet dhe njësitë e përkohshme të këtyre shtabeve.

1.6 Shtabet kombëtare: Shtabet e forcave kombëtare nën kontrollin dhe komandën e NATO-s.

1.7 Shtabet shumëkombëshe: Shtabe me personel të përbërë nga më shumë se një shtet, të formuara në bazë të marrëveshjes mes shteteve pjesëmarrëse dhe nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.8 Vendet dërguese (VD): Ato shtete dhe shtabe ose elementet e tyre të dërguara jashtë territorit të vendeve të tyre në territorin e vendit pritës, për të mbështetur operacionet e NATO-s.

1.9 Vendi pritës (VP): Republika e Shqipërisë.

1.10 Komandantët strategjikë ose komandat: Komandanti Suprem i Forcave të Aleancës në Europë, shtabi i së cilës është SHAPE.

1.11 Mbështetja e vendit pritës (MVP): Asistencë civile dhe ushtarake që i jepet nga një vend pritës forcave të aleatëve dhe organizatave në kohë paqeje, emergjence, krize dhe konflikti, dhe strukturat të cilat janë të vendosura, që operojnë apo janë transit në territorin e vendit pritës, në ujërat territoriale apo hapësirën ajrore të tij.

1.12 Forca mbrojtëse (FM): Të gjitha masat e marra dhe mënyrat e përdorura për të minimizuar cenueshmërinë e personelit, lehtësirat, pajisjet dhe operacionet kundrejt çdo rreziku dhe në çdo situatë për të mbrojtur lirinë e veprimit dhe efektivitetin operacional të forcave.

1.13 Shpenzimet: Shpenzimet të cilat lidhen me vendosjen, mbështetjen dhe mbajtjen e shtabeve kombëtare, shumëkombëshe ose shtabet ndërkombëtare, forcat ose organizatat e NATO-s. Për qëllim të këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe dokumenteve që do ta pasojnë:

a) Shpenzimet e përbashkëta të NATO-s. Këto shpenzime të cilat janë pranuar që më parë si

përgjegjësi kolektive e Aleancës.

b) Shpenzimet e përbashkëta. Për të cilat është rënë dakord më parë të jenë nën përgjegjësinë e përbashkët të më shumë se një kombi. Rregullimet për këto shpenzime zakonisht bazohen në një formulë të detajuar në marrëveshjen teknike përkatëse dhe/ose në rregullimet e përbashkëta të implementimit.

c) Kostoja kombëtare direkte. Shpenzimet që konsiderohen si përgjegjësi e një vendi dërgues (VD) të vetëm.

1.14 Fondi i përbashkët i NATO-s: Fondi i siguruar nga vendet e NATO-s dhe i livruar me miratim nëpërmjet buxhetit të NATO-s për shpenzimet e përbashkëta, të shkaktuara gjatë zhvillimit të operacioneve ose stërvitjeve përkatëse.

1.15 Notë pjesëmarrjeje (NP): Dokumenti që tregon qëllimin e (VD)-së për të marrë pjesë në përgatitjet mbi mbështetjen e vendit pritës sipas dispozitave të këtij MOU për një operacion të specifikuar të udhëhequr nga NATO.

1.16 Deklaratë qëllimi (DQ): Dokumenti që shpreh qëllimin e VD-së për të marrë pjesë në përgatitjet mbi mbështetjen e vendit pritës sipas dispozitave të këtij MOU, por i kushtëzuar nga kufizime specifike. Vendi pritës do të konfirmojë nëse kufizimet janë të pranueshme apo jo për sigurimin e mbështetjes së vendit pritës.

1.17 Marrëveshja teknike (MT): Përgatitje teknike dypalëshe që ndiqet për një operacion specifik të NATO-s. Detajon përgjegjësitë dhe procedurat për sigurimin e mbështetjes së vendit pritës kundrejt komandantit të NATO-s dhe vendit/ve dërguese.

1.18 Marrëveshja e Përbashkët e Zbatimit: Marrëveshja bilaterale që ndiqet, e cila përcakton angazhimet mes palëve nënshkruese në lidhje me sigurimin dhe marrjen e mbështetjes së vendit pritës. Marrëveshja përfshin informacion të detajuar mbi ndihmën e kërkuar dhe të ofruar, përcakton procedura specifike mbi vendndodhjen e implementimit dhe afatet e rimbursimit ose pagimit.

1.19 Komiteti Drejtues i Përbashkët mbi Mbështetjen e Vëndit Pritës: Komiteti i ngritur për këtë rast dhe i bashkëkryesuar nga vendi pritës dhe komandanti i NATO-s. Komiteti i përbërë nga përfaqësues të autorizuar nga të gjitha vendet dërguese, vendi pritës dhe komandanti i NATO-s do të mblidhen për të koordinuar përgatitjet zgjeruese të nevojshme që kanë të bëjnë me mbështetjen e vendit pritës, siç janë marrëveshja teknike dhe marrëveshjet e përbashkëta të zbatimit, sipas rastit.

1.20 Vendqëndrimet operacionale: Vendqëndrime të lokalizuara në territorin e vendit pritës, me qëllim mbështetjen operacionale dhe/ose logjistike për forcat në operacionet e drejtuara nga NATO-ja. Këto vendqëndrime janë detashmente të komandës strategjike nën komandën dhe kontrollin e komandantit të NATO-s.

1.21 Territori: Nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë tokën, hapësirën ajrore dhe ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë.

1.22 Stërvitjet: Në përputhje me Programin e NATO-s për Stërvitjen dhe Trajnimin Ushtarak, seria e stërvitjeve të përbashkëta për 2007 të quajtura Longbow 2007 (COLW 07) dhe Lancer 2007 (COLR 07), të cilat do të zhvillohen në Tiranë, Shqipëri, gjatë periudhës 1-30 tetor 2007, këtu e tutje referuar si "Stërvitjet".

1.23 Me përjashtim të rasteve kur kuptimi specifikohet në këtë MOU, aplikohet Fjalori i Termave dhe Përkufizimeve të NATO-s (AAP-6).

SEKSIONI 2 QËLLIMI

2.1 Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është të përcaktojë politikat dhe procedurat për krijimin e vendqëndrimeve operacionale dhe sigurimin e mbështetjes së vendit pritës ndaj forcave të NATO-s gjatë planifikimit, ekzekutimit dhe ridislokimit të stërvitjeve.

2.2 Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi dhe dokumentet që dalin prej saj kanë për qëllim krijimin e një bazë planifikimi për autoritetin e duhur të vendit pritës dhe komandantin e NATO-s, në pritje të përgatitjeve për mbështetjen e vendit pritës gjatë stërvitjeve.

SEKSIONI 3 SHTRIRJA DHE ANGAZHIMET E PËRGJITHSHME

3.1 Dispozitat e NATO-s ose të Pfp SOFA, Protokollit të Parisit dhe Protokollit Shtesë, dhe çdo marrëveshje tjetër në fuqi mes komandave strategjike të NATO-s dhe vendeve pritëse do të aplikohen gjatë stërvitjeve.

3.2 Vendi pritës njih vendqëndrimet operacionale të krijuara për implementimin e këtij Memorandumi si detashmente të komandës strategjike dhe veprimtaritë e këtyre detashmenteve të jenë sipërmarrje të komandës strategjike. Vendqëndrimet që do të krijohen, do të përcaktohen në dokumentet vijuese. Komanda dhe kontrolli i përgatitjeve do të vendosen në planet e zbatueshme operacionale ose stërvitore.

3.3 Ky Memorandum Mirëkuptimi do të jetë në përputhje me politikën dhe doktrinën e NATO-s dhe siguron një strukturë dhe përgatitje gjithëpërfshirëse për (MVP) mbështetjen e vendit pritës.

3.4 Vendi pritës do t'u sigurojë mbështetje me kapacitetin e tij të plotë forcave të dislokuara për stërvitje, në varësi të disponueshmërisë dhe brenda kufizimeve praktike të rrethanave ekzistuese të atëhershme. Detajet e kësaj mbështetjeje do të përcaktohen në dokumentet rezultuese.

3.5 Dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi aplikohen në kohë paqeje, emergjencash, krize dhe konflikti ose në periudha tensionesh ndërkombëtare, siç mund të përcaktohen reciprokisht nga autoritetet e duhura të vendit pritës dhe NATO-s.

3.6 Ndërsa vendet dërguese nxiten të marrin pjesë në stërvitjet dhe të pranojnë dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi si një dokument gjithëpërfshirës nën të cilin sigurohet mbështetja e vendit pritës, marrëveshje të veçanta bilaterale me shtete individuale mund të merren parasysh nga vendi pritës rast pas rasti.

3.7 Vendi pritës dhe komanda strategjike mund të përcaktojnë përfaqësues për të diskutuar në lidhje me dokumentacionin rezultues që mbështet dhe plotëson këtë MOU.

3.8 Stërvitjet e mbështetura nga ky Memorandum Mirëkuptimi mund të kërkojnë mbështetje shumëkombëshe për operacionet ajrore, përmes avionëve dhe helikopterëve me krahë të fiksuar dhe në rastin e porteve, përmes mjeteve lundruese mbështetëse ushtarake e tregtare. Vendi pritës pranon se lëvizja e këtyre avionëve, helikopterëve, anijeve dhe ekuipazheve në dhe përgjatë territorit të tij do të realizohet në bazë të një hapësire të përgjithshme gjatë kohëzgjatjes së operacionit. Vendi pritës do të kontrollojë/administrojë të gjitha aspektet e kësaj hapësire.

3.9 Ky Memorandum Mirëkuptimi ka për qëllim të jetë në harmoni me ligjet e vendit pritës dhe me çdo marrëveshje tjetër ndërkombëtare të zbatueshme.

SEKSIONI 4 DOKUMENTE TË REFERUESHME

Dokumentet e referueshme që mund të zbatohen në këtë Memorandum Mirëkuptimi janë në përmbajtje të shtojcës A.

SEKSIONI 5 PËRGJEGJËSITË

Brenda dispozitave të këtij Memorandumi Mirëkuptimi

5.1 Vendi pritës

a) Gjatë zhvillimit të dokumenteve mbështetëse të këtij MOU dhe sipas ndryshimeve që do të hasen, dhe pas plotësimit të këtyre dokumenteve, vendi pritës do të njoftojë në kohë komandën përkatëse të NATO-s lidhur me disponueshmërinë dhe ndonjë mangësi në kapacitetet e mbështetjes së vendit pritës. Vendi pritës duhet të ketë parasysh se projektet e NATO-s mbështeten në dokumentet e krijuara mbështetëse të kësaj Marrëveshjeje dhe kërkojnë njoftim në kohë për ndryshime të planifikuara në lidhje me krijimin dhe kapacitetin kombëtar.

b) Në mënyrë që të sigurohet mbështetja, vendi pritës do të realizojë përgatitjet e nevojshme me burime mbështetëse, përfshirë burime civile dhe tregtare. Mbështetja tregtare do të sigurohet nëpërmjet një procesi ofertash konkurruese prej ofertës më të ulët.

c) Vendi pritës do të mbajë të dhënat administrative e financiare të nevojshme për rimbursimin e vendit pritës për burimet e siguruara ndaj forcave. Të dhënat që dokumentojnë transaksionet e financuara nga buxhetet e NATO-s do t'i jepen NATO-s, kur të kërkohen për qëllim auditimi.

d) Standardi i mallrave dhe shërbimeve të ofruara nga vendi pritës do të jetë në përputhje me

detajet e përcaktuara në dokumentet shtesë mbështetëse.

e) Vendi pritës do të ruajë kontrollin e burimeve të tij mbështetëse, përveç rasteve kur kontrolli i këtyre burimeve është lënë i lirë.

f) Vendi pritës do të sigurojë përpara stërvitjeve, një listë çmimesh për çdo mbështetje përkatëse ose të identifikuar prej tij.

g) Vendi pritës do të ftojë vendet dërguese të pranojnë dispozitat e këtij MOU ose me anë të një note pjesëmarrjeje, ose deklarate qëllimi.

h) Vendi pritës do të sigurojë procedurat për një lidhje mjekësore midis vendit pritës dhe vendeve dërguese, përfshirë pikat e kontaktit mjekësor.

i) Vendi pritës do t'i sigurojë forcave mbështetje mjekësore dhe dentare, nëpërmjet personelit/shërbimeve ushtarake në të njëjtat kushte sikundër personelit ushtarak të vendit pritës.

j) Gjatë realizimit të mbështetjes dhe dokumentacionit rezultues, vendi pritës do të sigurojë për komandantin e NATO-s kopje të çdo rregulloreje që ka të bëjë me bujqësinë, shëndetësinë, shëndetin dhe sigurinë, të cilat mund të aplikohen në stërvitje, si edhe rregulloret që kanë të bëjnë me ruajtjen, lëvizjen ose depozitimin e materialeve të rrezikshme dhe municioneve.

k) Çdo kërkesë për mbështetje shtesë të paparashikuar nga MOU do të diskutohet ndërmjet Palëve ose ndërmjet vendit pritës dhe vendeve dërguese, me synim zgjidhjen e vështirësive logjistike nëpërmjet ekzekutimit të përgatitjeve shtesë për mbështetjen e vendit pritës.

5.2 Komandanti i NATO-s

a) Komandanti i NATO-s do të sigurojë në maksimumin e mundshëm që dokumentet mbështetëse të specifikojnë tipin, masën dhe cilësinë e mbështetjes së kërkuar. Është vërejtur se misioni dhe struktura e forcave nuk mund të specifikohen para hartimit të Planit të Operacionit (OPLAN), Mandatit Operacional (OPORD) ose Rendit Operacional të Stërvitjes. Komanda e NATO-s do të sigurojë informacion shtesë të nevojshëm për planifikimin nga ana e vendit pritës sa më shpejt që të jetë e mundur.

b) Komandanti i NATO-s do të njoftojë në kohë vendin pritës për çdo ndryshim, sipas rrethanave dhe do të propozojë modifikime të dokumenteve rezultues, sipas nevojës.

c) Komandanti i NATO-s do të përcaktojë nëse financimi i përbashkët është i disponueshëm dhe se cilat kërkesa janë të pranueshme për një financim të tillë.

d) Komandanti i NATO-s do të përcaktojë dhe vendosë prioritetet mbi mbështetjen e vendit pritës dhe do të miratojë kuotat e pagesave të përbashkëta.

e) Komandanti i NATO-s do të sigurojë rimbursime financiare për vendin pritës për mbështetjen e vendit pritës të rënë dakord, nëse parashikohet të paguhet nëpërmjet fondit të përbashkët. Në të gjitha rastet e tjera, komandanti i NATO-s do të ndihmojë sa të jetë e mundur në zgjidhjen e detyrimeve financiare mes vendit pritës dhe vendeve dërguese.

f) Nëse kërkesat e vendeve dërguese nuk përputhen me prioritetet e shpërndarjes së burimeve të komandës së NATO-s, komanda përkatëse e NATO-s do të zgjidhë konfliktin me vendet dërguese të përfshira.

g) Komandanti i NATO-s do të identifikojë personelin dhe kërkesat e tjera për vendqëndrimin operacional që do të ngrihet në vendin pritës.

h) Komandanti i NATO-s do të lehtësojë standardizimin e kërkesave dhe pagesave për mbështetje gjatë negociatave dhe/ose në komitetin drejtues të përbashkët mbi mbështetjen e vendit pritës.

5.3 Vendet dërguese

a) Vendet dërguese mund të zgjedhin për të marrë pjesë në procedurat dhe strukturat për mbështetjen e vendit pritës, duke pranuar dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi nëpërmjet një note pjesëmarrjeje dhe/ose deklaratës së qëllimit.

b) Vendet dërguese do të identifikojnë kërkesat e mbështetjes të vendit pritës dhe komandantit përgjegjës të NATO-s.

c) Për kërkesat e kostos së drejtpërdrejtë kombëtare, vendet dërguese do të marrin pjesë në negociata për mbështetjen e vendit pritës gjatë takimit të komitetit drejtues të përbashkët mbi mbështetjen e vendit pritës ose direkt me vendin pritës, nëse komiteti drejtues i përbashkët mbi mbështetjen e vendit pritës nuk është krijuar ende. Vendet e pritjes do të sigurojnë pagesë direkte ose rimbursojnë mbështetjen e vendit pritës vetëm për shërbimet e siguruar nga burime ushtarake, me përjashtim të rasteve kur procedura të tjera përdoren siç është rënë dakord. Sipas marrëveshjeve kontraktuale të bëra ndërmjet

vendit pritës dhe vendeve dërguese, mbështetja e siguruar nga burimet private ose civile do të paguhet drejtpërdrejt nga vendet dërguese.

d) Vendet dërguese do të sigurojnë një personel të autorizuar për të marrë pjesë në bisedimet me vendin pritës në komitetin drejtues të përbashkët mbi mbështetjen e vendit pritës, nëse ekziston.

e) Vendet dërguese do të raportojnë ndryshimet në kërkesat e mbështetjes së vendit pritës dhe komandantit përkatës të NATO-s, kur ato ndodhin dhe paraqesin kërkesat e rishikuara dhe/ose raportet për statusin.

f) Vendet dërguese janë përgjegjëse për koston e çdo shërbimi mjekësor dhe dentar civil të siguruar nga vendi pritës.

g) Vendet dërguese duhet të ndjekin rregulloret dhe procedurat mbi bujqësinë, ambientin, sigurinë, dhe shëndetin e vendit pritës, të përcaktuara për vendqëndrimet operacionale, si dhe çdo rregullore të vendit pritës mbi ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme.

SEKSIONI 6 DISPOZITA FINANCIARE

6.1 Në bazë të marrëveshjeve dhe/ose konventave ndërkombëtare të ndërsjella, aktivitetet e shtabeve ndërkombëtare, vendqëndrimet operacionale, mjetet në pronësi dhe/ose në zotërim nga NATO, avionët, automjetet, POL dhe forcat të cilat i sigurohen NATO-s, do të jenë të përjashtuara nga të gjitha taksat, detyrimet, tarifat e shtetit dhe detyrime të tjera të ngjashme me to.

6.2 Protokolli i Parisit dhe Protokolli i Mëtejshëm Shtesë, i cili zbaton imunitete dhe privilegje për shtabet e NATO-s, do të aplikohet për çdo shtab ndërkombëtar, njësitë dhe detashmentet e të cilëve mund të dislokohen në vendin pritës për qëllim të stërvitjes.

6.3 Atëherë kur nuk është i mundur përjashtimi i plotë nga taksat, detyrimet, tarifat dhe detyrime të tjera, detyrimet nuk do të jenë në shkallë më të lartë se ato që zbatohen për forcat e armatosura të vendit pritës. Të gjitha shpenzimet duhet të kryhen me vlerën më të vogël të kërkesave administrative shoqëruese.

6.4 Transaksionet financiare, në mënyrë që të përfshijnë transferimin e fondeve dhe krijimin e llogarive bankare në çdo bankë private ose shtetërore, duhet të zhvillohen të përjashtuara nga detyrimet dhe tarifat e çdo lloji.

6.5 Rregullimet përfundimtare financiare, në mënyrë të veçantë ato që lidhen me fondin e përbashkët të NATO-s, mundësisht do të përcaktohen vetëm para implementimit të stërvitjeve. Megjithatë, të gjitha negociatat financiare të bëra paraprakisht, duhet të bëhen specifike sipas detyrimeve financiare maksimale të NATO-s. Shpenzimet e paspecifikuara si shpenzime nga buxheti i NATO-s, para se të shkaktohen, nuk do të përfshihen në fondin e përbashkët të NATO-s.

6.6 Dokumentet pasuese do të sigurojnë bazën fillestare për vlerësimet e koston dhe do të shërbejnë si bazë për kategorizimin e shpenzimeve ose si shpenzime të përbashkëta të NATO-s (nëse është e zbatueshme), shpenzime të përbashkëta ose shpenzime kombëtare të drejtpërdrejta.

6.7 Nëse komandanti i NATO-s përcakton që disa shpenzime të caktuara janë si të pranueshme, ashtu edhe të përballueshme për fondin e përbashkët të NATO-s (nga akordimet e miratuara të buxhetit), komanda strategjike do të autorizojë financim të përbashkët për ato shpenzime dhe ose do t'i paguajë drejtpërsëdrejti ose ta rimbursojë vendin pritës.

6.8 Nëse disa shpenzime janë parashikuar t'i atribuohen më shumë se një vendi, këto shpenzime mund të identifikohen si shpenzime të përbashkëta dhe me marrëveshje të vendeve të përfshira, mund të ndahen në përputhje me një formulë për ndarjen e shpenzimeve të miratuara në marrëveshjen teknike ose në dokumente të tjera mbështetëse.

6.9 Për kërkesat e koston së drejtpërdrejtë kombëtare, vendi dërgues normalisht do të marrë pjesë në negociata për mbështetjen e vendit pritës në komitetin drejtues të përbashkët mbi mbështetjen e vendit pritës ose drejtpërdrejt me vendin pritës, nëse komiteti nuk është krijuar ende. Vendet dërguese do të sigurojnë pagesë të drejtpërdrejtë ose rimbursim për mbështetjen e vendit pritës, vetëm për shërbime të siguruar nga burime ushtarake, me përjashtim të rasteve kur procedura të tjera pagese përdoren, siç është rënë dakord. Sipas marrëveshjeve kontraktuale mes vendit pritës dhe vendeve dërguese, mbështetja e siguruar prej burimeve civile dhe tregtare do të paguhet direkt nga vendet dërguese.

6.10 Detyrimet për materialet dhe shërbimet civile dhe ushtarake të siguruar nga vendi pritës

nuk do të shlyhen në një shkallë më të lartë se shlyerja për forcat e armatosura të vendit pritës dhe nuk do të përfshijnë shpenzime shtesë administrative ose shpenzime të tepërta, por mund të reflektojnë rregullime për shkak të programit të shpërndarjes, pikave të shpërndarjes ose elementeve të ngjashme. Rimbursimi nuk do të paguhet për mbështetjen e siguruar nga personeli ushtarak.

6.11 Komandanti i NATO-s dhe vendet dërguese mund të kontraktojnë drejtpërdrejt me ofertues tregtarë për oferta, shërbime dhe nevoja të tjera.

6.12 Automjetet në pronësi të NATO-s dhe automjetet ushtarake të vendeve dërguese janë të vetësiguruara dhe si të tilla mund të veprojnë pa siguracion tregtar brenda territorit të vendit pritës.

6.13 Vendi pritës nuk shkakton detyrime financiare në emër të komandantit të NATO-s ose vendeve dërguese, përveç rasteve kur i kërkohet specifikisht ta bëjë këtë më përpara nga një përfaqësues i autorizuar dhe në rastet kur është pranuar përgjegjësia për pagimin e shpenzimeve. Për më tepër, asnjë fond nuk do të livrohet derisa komanda strategjike ose vendet dërguese, sipas nevojës, të miratojnë dokumentet mbështetëse përkatëse dhe të drejtojnë implementimin e tyre.

6.14 Financimi nuk jepet në lidhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi dhe ky dokument nuk përfaqëson një detyrim specifik financimi nga ana e komandantit të NATO-s ose vendeve dërguese. Marrëveshje të veçanta financiare dhe procedura rimbursimi do të specifikohen në dokumentet pasuese.

6.15 Vendosja e zonave operacionale për të mbështetur një operacion të NATO-s nuk parashikon ndërtimin ose rehabilitimin e infrastrukturës.

SEKSIONI 7 DISPOZITA LIGJORE

7.1 Komandat strategjike do të ekzekutojnë ose mund të delegojnë veprime ligjore thelbësore për realizimin e misioneve, përfshirë këtu, por jo kufizuar me ushtrimin e së drejtës për të kontraktuar, për t'u përfshirë në procese ligjore ose administrative dhe për të përfituar e shfrytëzuar pasuri.

7.2 Statusi i forcave të dislokuara në territorin e vendit pritës do të përcaktohet në përputhje me NATO-n ose PfP SOFA, Protokollin e Parisit dhe/ose Protokollin e Mëtejshëm Shtesë.

7.3 Pajisjet, furnizimet, prodhimet dhe materialet e importuara përkohësisht dhe të eksportuara nga territori i vendit pritës në lidhje me stërvitjen, janë të përjashtuara nga të gjitha detyrimet, taksat dhe tarifatat. Procedura të tjera doganore do të përcaktohen në përputhje me NATO-n ose PfP SOFA, Protokollin e Parisit dhe Protokollin e Mëtejshëm Shtesë, si të jetë e zbatueshme.

7.4 Pretendimet jokontraktuale që rrjedhin nga, ose në lidhje me zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi të natyrës së nenit 7 të NATO SOFA-s, do të zgjidhen në përputhje me dispozitat e nenit të lartpërmendur.

7.5 Pretendimet kontraktuale do të shqyrtohen dhe zgjidhen nga vendi pritës, përmes procesit që drejton kontratat publike dhe në përputhje me ligjet e vendit pritës, me rimbursim nga komandanti i NATO-s ose vendet dërguese.

7.6 Anëtarët e Forcës do të kenë me vete këto dokumente kur hyjnë ose kalojnë kufijtë e vendit pritës dhe do t'i paraqesin ato kur iu kërkohet:

- Karta ushtarake e identitetit kombëtare/e NATO-s.
- Urdhri individual ose kolektiv i udhëtimit i NATO/PfP.

Vendi pritës do të pranojë këto dokumente si dokumente të rregullta për hyrjen në pikat e kalimit kufitar nga anëtarët e Forcës, pa ndonjë kërkesë shtesë.

SEKSIONI 8 MBROJTJA E FORCËS

8.1 Një mbrojtje e plotë dhe efektive e Forcës do të planifikohet për qëllim të stërvitjeve dhe do të detajohet në marrëveshjet OPLANS, EXPI ose marrëveshjet shtesë, sipas nevojës. Mbrojtja e Forcës do të zbatohet në përputhje me politikën dhe procedurat e NATO-s, dhe në mënyrë të pajtueshme me NATO-n ose PfP-SOFA. Mbrojtja e Forcës në asnjë mënyrë nuk do të kërkohet ose sigurohet në kundërshtim me ligjet e NATO-s/PfP/SOFA ose ligjet e vendit pritës.

8.2 Sipas rastit, vendi pritës do të informojë vendin dërgues dhe komandantin e NATO-s për masat dhe kufizimet e propozuara të mbrojtjes së Forcës.

8.3 Sipas rastit, secili vend dërgues është përgjegjës për identifikimin dhe sigurimin e kërkesave dhe kufizimeve të mbrojtjes së Forcës, vendit pritës dhe komandantit të NATO-s.

8.4 Përveç përgjegjësive të mbrojtjes së Forcës, të përcaktuara në politikën dhe procedurat e NATO-s, komandanti i NATO-s është përgjegjës për koordinimin e mbrojtjes së Forcës së kërkuar dhe të siguruar nga vendi pritës dhe vendet dërguese, sipas nevojës për mbrojtjen e Forcës.

SEKSIONI 9

9.1 Pjesëmarrësit dhe vendet dërguese do t'i konfirmojnë NATO-s procedurat ekzistente të sigurisë, përdorimin, transmetimin dhe ruajtjen e të gjithë informacionit të klasifikuar, që mbahet, përdoret, krijohet, sigurohet ose shkëmbehet.

9.2 Informacioni i siguruar një tjetri nga ana e një pjesëmarrësi ose vendi dërgues në konfidencë dhe informacion të tillë të siguruar nga çdo pjesëmarrës ose vend dërgues që kërkon fshehtësi, ose do të mbajë klasifikimin e tij fillestar ose do t'i caktohet një nivel klasifikimi që do t'i sigurojë një shkallë mbrojtjeje kundër zbulimit, të njëjtë me atë që kërkohet nga pjesëmarrësi tjetër ose vendi dërgues.

9.3 Secili pjesëmarrës dhe vend dërgues do të ndërmarrë hapa ligjorë të disponueshëm për të mbrojtur nga zbulimi të gjithë informacionin e shkëmbyer në konfidencë, përveçse kur pjesëmarrësit e tjerë dhe/ose vendet dërguese e miratojnë një zbulim të tillë.

9.4 Për të ndihmuar në sigurimin e mbrojtjes së kërkuar, secili pjesëmarrës ose vend dërgues do të shënojë informacionin e dhënë tjetrit në konfidencë me një legjendë që tregon origjinën e tij, klasifikimin e sigurisë, kushtet e publikimit, që ky informacion ka lidhje me një operacion specifik të NATO-s dhe se ai është siguruar në konfidencë.

9.5 Vizita nga ana e personelit do të kryhet në përputhje me procedurat e specifikuar në C-M (2002) 49, sipas ndryshimeve.

SEKSIONI 10

FILLIMI, KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI

10.1 Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi në datën kur komandanti i NATO-s merr njoftimin me shkrim nga vendi pritës për përmbushjen e të gjitha procedurave të nevojshme për hyrjen në fuqi të MOU-t. Ky Memorandum do të mbetet në fuqi deri në largimin e plotë të forcave. Komanda e NATO-s do të njoftojë vendin pritës kur largimi i plotë të jetë kryer.

10.2 Të gjitha dispozitat e seksionit 6, 7 dhe 9 do të mbeten në fuqi, në rast të tërheqjes së ndonjë pjesëmarrësi ose pas përfundimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve. Vendet dërguese do të përmbushin të gjitha detyrimet në rast të çdo përfundimi ose tërheqjeje.

SEKSIONI 11

NDRYSHIMET, INTERPRETIMI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

11.1 Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të modifikohet ose ndryshohet me shkrim, me pëlqim të përbashkët të të gjithë pjesëmarrësve.

11.2 Çdo konflikt për interpretimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të zgjidhet me konsultim mes palëve në nivelin me të ulët të mundshëm dhe nuk do t'i referohet për zgjidhje një gjykatë kombëtare ose ndërkombëtare ose një pale të tretë për zgjidhje.

11.3 Ky Memorandum Mirëkuptimi është firmosur në tri kopje, secila në gjuhën shqipe dhe angleze.

11.4 Problemet e përkthimit ose të interpretimit të këtij MOU do të zgjidhen sipas variantit të gjuhës angleze. Memorandumi paraprirës paraqet mirëkuptimin e plotë mbi çështjet e referuara në këtë dokument, të arritur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shtabit Suprem të Forcave Aleate të Europës të përfaqësuara nga Shtabi i Komandës së Divizionit Aleat Tokësor Heidelberg.

NËNSHKRUAR:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Petrit Karabina

Zëvendësministër i MOD-it

Në emër të Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE)

Carsten Svensson

Major General, DA Army

Chief of Staff

Shtabi i Komandës së Divizionit Aleat Tokësor Heidelberg

SHTOJCA A E MOU-T

Dokumentet e referimit

- a) Traktati i Atlantikut të Veriut më 4 prill 1949.
- b) Dokumenti Bazë i Partneritetit për Paqe, i lëshuar nga kryetarët e shteteve dhe vendet pjesëmarrëse në Mbledhjen e Këshillit të Atlantikut Verior më 10 janar të vitit 1994.
- c) Marrëveshja ndërmjet Palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut lidhur me Statusin e Forcave të tyre (NATO SOFA), të datës 19 qershor 1951.
- d) Marrëveshja ndërmjet shteteve palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe lidhur me Statusin e Forcave të Tyre (NATO SOFA), të datës 19 qershor 1995.
- e) Protokollin Shtesë i Mëtejshëm i Marrëveshjes midis Shteteve Palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe lidhur me Statusin e Forcave të Tyre, 19 dhjetor 1997.
- f) Protokollin për Statusin e Shtabeve Ushtarake Ndërkombëtare të ngritura në vijim të Traktatit të Atlantikut të Veriut (Protokollin i Parisit), datë 28 gusht 1952.
- g) MC 319/1- Parimet dhe Politikat Logjistike të NATO-s.
- h) MC 334/1- Parimet dhe Politikat e NATO-s për Mbështetjen e Vendit Pritës.
- i) STANAG-et e aplikueshme të NATO-s dhe Direktivat Orientuese për Mbështetjen Logjistike, Mbrojtjen e Forcave dhe Rimbursimi Financiar.
- j) AJP-4.5 (A)-Publikimet e Përbashkëta të Aleancës në lidhje me Doktrinat dhe Procedurat e Mbështetjes së Vendit Pritës.
- k) CM(2002)50-Masat Mbrojtëse për Trupat Civile dhe Ushtarake të NATO-s, Dislokimi i Forcave dhe Bazave Ushtarake të NATO-s (Asetet) kundër Kërcënimeve Terroriste.
- l) BI-SC Direktivat e Mbrojtjes së Forcave 80-25, 1 janar 2003
- m) BI-SC Guida e Planifikimit Veprues për Mbrojtjen e Forcave.
- n) AAP-6-Fjalori i Terminologjisë.
- o) C-M (2002) 49, Siguria brenda Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

LIGJ

Nr.9758, datë 21.6.2007

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË GARANCISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH) PËR MARRËVESHJEN E KREDISË NDËRMJET AUTORITETIT PORTUAL DURRËS DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “NDËRTIMI I TERMINALIT TË TRAGETEVE DHE I SHESHEVE PËRRETH NË PORTIN E DURRËSIT””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për marrëveshjen e kredisë ndërmjet Autoritetit Portual Durrës dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për financimin e projektit “Ndërtimi i terminalit të trageteve dhe i shesheve përreth në Portin e Durrësit””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5379, datë 26.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

(Numri i veprimit 35862)

MARRËVESHJE GARANCIE (PORTI I DURRËSIT) NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Kjo projektmarrëveshje garancie është përgatitur vetëm me qëllim diskutimi.

Mund të shtohen dispozita të tjera dhe teksti ekzistues i nënshtrohet ndryshimit dhe miratimit përfundimtar nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Datë _____

Marrëveshje e datës (____) ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Garantuesi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka).

HYRJE

Ndërsa Garantuesi dhe Autoriteti i Portit të Durrësit kanë kërkuar asistencë nga Banka në financimin e një pjese të Projektit;

ndërsa në pajtim me marrëveshjen e huasë të datës së kësaj ndërmjet Autoritetit të Portit të Durrësit si Huamarrësi dhe Bankës (Marrëveshja e huasë, sipas përcaktimit në termat dhe kushtet standarde), Banka ka rënë dakord t'i japë hua Huamarrësit në shumën 14 000 000 euro, në pajtim me termat dhe kushtet e parashikuara ose referuara në këtë Marrëveshje huaje, por vetëm me kusht që Garantuesi të japë garanci detyrimet e Huamarrësit në bazë të Marrëveshjes së huasë, sipas parashikimit në këtë Marrëveshje;

ndërsa Garantuesi, duke pasur parasysh që Banka ka lidhur Marrëveshje huaje me Huamarrësin, ka rënë dakord të garantojë këto kushte të Huamarrësit,

kështu, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Termat dhe kushtet standarde, përkufizime

Seksioni 1.01 Përfshirja e termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të Bankës të datës 1 maj 2006 përfshihen dhe bëhen të zbatueshme në këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin parashikuar në të.

Seksioni 1.02 Përkufizime

Kurdoherë që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë hyrjen), përveç kur përcaktohet ndryshe ose konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuar në hyrje kanë kuptimet përkatëse që u janë dhënë atje, termat e përcaktuara në termat dhe kushtet standarde kanë kuptimet përkatëse që u janë dhënë atyre atje dhe termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

“Përfaqësuesi i autorizuar i Garantuesit” është Ministri i Financave i Garantuesit.

Seksioni 1.03. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, një referencë në një nen ose seksion, nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si një referencë në këtë nen ose seksion të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Garancia, detyrime të tjera

Seksioni 2.01. Garancia

Garantuesi këtu garanton pa kushte si debitori primar dhe jo thjesht si dorëzanë, pagesën e duhur dhe në kohë të të gjitha shumave të kërkueshme në bazë të kësaj Marrëveshjeje huaje, qoftë në kohën e maturimit, me përshpejtim apo ndryshe dhe përmbushjen me korrektesë të të gjitha detyrimeve të tjera të Huamarrësit, sipas parashikimit në Marrëveshjen e huasë.

Seksioni 2.02 Përfundimi i projektit

Kurdoherë që ka shkak të pranueshëm për të besuar që fondet e ofruara Huamarrësit do të jenë të papërshtatshme për të mbuluar shpenzimet e parashikuara të kërkuara për zbatimin e projektit, Garantuesi merr menjëherë masa të pranueshme për Bankën që i japin Huamarrësit ose i shkaktojnë Huamarrësit marrjen e këtyre fondeve që janë të nevojshme për të mbuluar këto shpenzime dhe kërkesa.

Seksioni 2.03 Detyrime të tjera

a) Garantuesi nuk vendos asnjë taksë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë për konsulentët e huaj të punësuar nga Banka ose Huamarrësi në zbatimin e projektit dhe financuar nga shumat e huasë.

b) Garantuesi siguron që Huamarrësi të mos deklarojë apo paguajë një dividend në lidhje me ndonjë vit fiskal më shumë se 20% të fitimeve neto të Huamarrësit për këtë vit fiskal.

c) Pa kufizuar përgjithësimin e ndonjë dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje ose të termave dhe kushteve standarde, Garantuesi siguron që të mos merret apo të mos lejohet të merret asnjë veprim nga Garantuesi apo ndonjë prej nënndarjeve të tij politike apo administrative apo ndonjë subjekt tjetër që është në pronësi ose kontrollon ose operohet për llogari ose në interes të Garantuesit apo këtyre nënndarjeve, që do të pengonte ose ndërhynte në ekzekutimin e projektit ose në operimin efikas të mjeteve të projektit ose përmbushjen e detyrimeve të Huamarrësit në bazë të Marrëveshjes së huasë.

Neni 3

Të ndryshme

Seksioni 3.01 Njoftimet

Adresat e mëposhtme përcaktohen për qëllimet e seksionit 10.01 të termave dhe kushteve standarde:

Për Garantuesin:

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë

Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", 1

Tirana

Republika e Shqipërisë

Në vëmendje të: Ministrit të Financave

Fax: + 355 4 228 494 +355 4 229 200

Për Bankën:

European Bank for Reconstruction and Development

One Exchange Square

London EC2A 2JN

United Kingdom

Në vëmendje të: Operation Administration Unit (Opid 35862)

Fax: + 44 20 7338 6100

Telex: 8812161

Answerback: EBRD L G

Seksioni 3.02 Mendimi ligjor

Për qëllimet e seksionit 9.03(b) të termave dhe kushteve standarde dhe në pajtim me seksionin 6.02(b) të Marrëveshjes së huasë, mendimet ose opinionet e këshilltarit jepen në emër të Garantuesit nga Ministri i Drejtësisë.

Në dëshmi të kësaj, Palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë bërë nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje në katër kopje dhe dërgimin në Tiranë, Republika e Shqipërisë në ditën dhe vitin e treguar më sipër.

Republika e Shqipërisë

Nga: _____

Emri

Titulli Ministër i Financave

Banka Europiane

Për Rindërtim dhe Zhvillim

Nga: _____

Emri

Titulli

Numri i veprimit 35862

MARRËVESHJE HUAJE

**(PORTI I DURRËSIT) NDËRMJET AUTORITETIT TË PORTIT TË DURRËSIT
DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Kjo projekt marrëveshje huaje është përgatitur vetëm me qëllim diskutimi.

Mund të shtohen dispozita të tjera dhe teksti ekzistues i nënshtrohet ndryshimit dhe miratimit përfundimtar nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Datë _____

Marrëveshje e datës (_____) ndërmjet Autoritetit të Portit të Durrësit (Huamarrësi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka).

HYRJE

Ndërsa Banka është themeluar për të dhënë financim për projekte të veçanta për të nxitur tranzicionin drejt ekonomive të hapura, të orientuara nga tregu dhe për të nxitur iniciativën private dhe sipërmarrëse në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore të angazhuar dhe që zbatojnë parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomive të tregut;

ndërsa Huamarrësi synon të zbatojë projektin sipas përshkrimit në planin kohor 1 që është i destinuar për të ndihmuar Huamarrësin për të lehtësuar ndërtimin e një terminali të ri të trageteve dhe infrastrukturës përkatëse dhe rehabilitimit të platformave 7 dhe 8 në Portin e Durrësit;

ndërsa tashmë mendohet që Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit do të mbajë përgjegjësinë e përgjithshme për sektorin e porteve, duke përfshirë mbikëqyrjen e zbatimit të projektit;

ndërsa Republika e Shqipërisë dhe Huamarrësi kanë kërkuar asistencë nga Banka për pjesën e financimit të projektit;

ndërsa një hua nga Banka Europiane e Investimeve (Bashkëfinancuesi) në shumën prej 18, 000,

000 euro (Huaja EIB) është marrë për të asistuar në bashkëfinancimin e projektit, në pajtim me termat dhe kushtet e parashikuara në një marrëveshje (Marrëveshja e bashkëfinancimit) që dokumenton termat e huasë EIB;

ndërsa një fond granti nga Bashkimi European në shumën 2, 200, 000 euro (Fondet e grantit të BE-së) është marrë për të asistuar në përgatitjen e disenjos së detajuar dhe sigurimin e shërbimeve të mbikëqyrjes sipas projektit;

ndërsa në pajtim me një marrëveshje garancie të datës së kësaj ndërmjet Republikës së Shqipërisë si Garantues dhe Bankës (Marrëveshja e garancisë sipas përcaktimit në termat dhe kushtet standarde), Garantuesi ka garantuar detyrimet e Huamarrësit në këtë Marrëveshje; dhe

ndërsa Banka ka rënë dakord, ndërmjet të tjerash, për sa më sipër për t'i dhënë një hua Huamarrësit në shumën 14.000.000 euro, në pajtim me termat dhe kushtet e parashikuara ose të referuara në këtë Marrëveshje,

kështu, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Termet dhe kushtet standarde, përkufizime

Seksioni 1.01. Përfshirja e termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të Bankës të datës 1 maj 2006 përfshihen dhe bëhen të zbatueshme në këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin parashikuar në të.

Seksioni 1.02. Përkufizime

Kurdoherë që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë hyrjen dhe planet kohore), përveç kur përcaktohet ndryshe ose konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuara në hyrje kanë kuptimet përkatëse që u janë dhënë atje, termat e përcaktuara në termat dhe kushtet standarde kanë kuptimet përkatëse që u janë dhënë atje dhe termat e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme:

“Përfaqësuesi i autorizuar i Huamarrësit” është drejtori ekzekutiv i Huamarrësit.

“Plani i veprimit në ambient” është plani i veprimit në ambient për projektin e rënë dakord si kusht për efektin e kësaj Marrëveshjeje, në pajtim me seksionin 6.01(c), ashtu si ky plan veprimi në ambient mund të ndryshohet herë pas here me pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës, duke përfshirë në pajtim me seksionin 2.03(b)(1).

“Çështje e ambientit” do të thotë:

- ndotja ose mbrojtja e ambientit;
- dëmtimi ose mbrojtja e shëndetit të njeriut;
- shëndeti dhe siguria në vendin e punës; ose
- çdo emetim ose substancë që i shkakton dëm një organizmi të gjallë apo ambientit.

“Vit fiskal” do të thotë viti fiskal i Huamarrësit që fillon në 1 janar të çdo viti.

“IFRS” do të thotë Standarde Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të nxjerra ose miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe që zbatohen vazhdimisht.

“PIU” do të thotë njësia e zbatimit të projekteve, e përmendur në seksionin 3.02.

“Çështje sociale” do të thotë:

- standardet e punës dhe kushtet e punësimit sipas rregullimit nga ligji i zbatuar;
- ndikimi mbi personat nga rivendosja ose përftimi i tokës;
- ndikimi mbi personat vendas ose grupet e tjera të pambrojtura;
- ndikimi mbi objektet e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë reliket dhe vendet arkeologjike;

ose

e) konsultimet dhe deklaratimet publike, duke përfshirë ankesat nga anëtarët e publikut që i njoftohen Huamarrësit.

“Statutet” janë statutet e Huamarrësit, sipas miratimit nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.596, datë 10 shtator 2004.

Seksioni 1.03. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, një referencë në një nen, seksion apo plan kohor të përcaktuar, nëse nuk përcaktohet ndryshe në të, interpretohet si referencë në këtë nen ose seksion apo plan kohor të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
Termet kryesore të Huasë

Seksioni 2.01. Shuma dhe monedha

a) Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose referuara në këtë Marrëveshje, shumën 14,000,000 euro.

b) Huaja përbëhet nga dy transhe, si më poshtë:

- 1) Transhi 1 në shumën 10, 700, 000 euro; dhe
- 2) Transhi 2 në shumën 3, 300, 000 euro.

Seksioni 2.02. Terma të tjera financiare të huasë

a) Shuma minimale e tërheqjes është 250, 000 euro.

b) Shuma minimale e parapagimit është 2, 500, 000 euro.

c) Shuma minimale e anulimit është 1, 000, 000 euro.

d) Datat e pagesës së interesit janë 6 prill dhe 6 tetor i çdo viti.

e) (1) Huamarrësi e shlyen huanë në 24 këste të barabarta (ose sa më të barabarta që të jetë e mundur) gjysmëvjetore në secilën datë të pagesës së interesit, me këstin e parë që bëhet i kërkueshëm më 6 tetor 2010.

2) Pavarësisht nga sa më sipër, në rastin kur: (i) Huamarrësi nuk e tërheq të gjithë shumën e huasë para datës së parë të shlyerjes së përcaktuar në seksionin 2.02.(e), dhe (ii) Banka e shtyn datën e fundit të disponibilitetit të përcaktuar në seksionin 2.02.(f) më poshtë në një datë që bie pas datës së parë të shlyerjes së huasë, atëherë shuma e secilës tërheqje e bërë në ose pas datës së parë të shlyerjes së huasë alokohet për shlyerjen në shumën të barabarta në disa data të shlyerjes së huasë që bien pas datës së kësaj tërheqjeje (ku Banka përshtat shumën e dhëna që janë të nevojshme për të përfshirë të gjitha shifrat në secilin rast). Banka, herë pas here, njofton Huamarrësin në lidhje me këto alokime.

f) Data e fundit e përfitimit është 1 tetori i vitit 2010, ose një datë e mëvonshme që mund të caktohet nga Banka në diskrecionin e saj dhe që njofton Huamarrësin dhe Garantuesin.

g) Tarifa e zotimit financiar është 0.50% në vit.

h) Huaja i nënshtrohet interesit variabël. Pavarësisht nga sa më sipër, Huamarrësi, si alternativë e pagesës së interesit variabël për të gjithën ose një pjesë të huasë së pashlyer, mund të zgjedhë të paguajë një interes fikse për këtë pjesë të huasë në pajtim me seksionin 3.04(c) të termave dhe kushteve standarde.

Seksioni 2.03. Tërheqjet

a) Shuma e ofruar mund të tërhiqet herë pas here në pajtim me dispozitat e planit kohor 2, për të financuar:

1. në rastin e transhit 1: (i) shpenzimet e bëra (ose, nëse Banka bie dakord, që do të bëhen) në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara për pjesën 1 të projektit dhe (ii) komisionin të fazës fillestare të projektit; dhe

2. në rastin e transhit 2, dhe në pajtim me paragrafin (b) të mëposhtëm, shpenzimet e bëra (ose, nëse Banka bie dakord, që do të bëhen) në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara për pjesën 2 të projektit.

b) Banka nuk ka asnjë detyrim që të realizojë ndonjë tërheqje të transhit 2, nëse nuk janë përmbushur kushtet e mëposhtme në formën dhe përmbajtjen e pranueshme për Bankën:

1. plani i veprimit për ambientin është ndryshuar për të reflektuar aktivitetet e përshkruara në pjesën 2 të projektit;

2. është emëruar një konsulent mbikëqyrës për të monitoruar të gjitha aspektet e zbatimit të punimeve të pjesës 2 të projektit me personel dhe kushtet e referencës të pranueshme për Bankën;

3. është emëruar një konsulent me personelin dhe me termat e referencës të pranueshme për Bankën për të asistuar Huamarrësin për zbatimin e procedurave të kontrollit të llogarive dhe shpenzimeve, me qëllim që të paraqesë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të gjendjes financiare të Huamarrësit dhe rezultatet e operacioneve të tij në pajtim me IFRS-në; dhe

4. janë marrë të gjitha lejet e zbatueshme të ambientit dhe ndërtimit për zbatimin e pjesës 2 të projektit.

Seksioni 2.04 Çështje të përgjithshme

Për shmangien e çdo dyshimi:

a) çdo shlyerje ose parapagim i huasë kryhet ndërmjet transhit 1 dhe transhit 2 në raport me shumat e papaguara; dhe

b) çdo pezullim ose anulim i huasë kryhet ndërmjet shumave të patërhequra të transhit 1 dhe transhit 2 në raportet e zgjedhura nga Banka.

Neni 3

Ekzekutimi i projektit

Seksioni 3.01 Kushte të tjera pohore të projektit

Përveç detyrimeve të përgjithshme të parashikuara në nenin IV të termave dhe kushteve standarde, Huamarrësi, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe:

a) ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të dhënë fonde të përshtatshme për përfundimin e projektit, duke përfshirë të gjitha taksat dhe pagesat e caktuara nga ose në emër të Republikës së Shqipërisë;

b) në ose para datës 31 dhjetor 2008, zbaton procedurat e kontrollit të llogarive dhe shpenzimeve që mundësojnë auditimin e deklarimeve financiare të Huamarrësit në pajtim me IFRS-në;

c) në ose para datës 30 qershor 2009 dhe çdo 30 qershor pas kësaj, merr masa që të realizohet auditimi në pajtim me IFRS-në nga auditues ndërkombëtarë të pranueshëm për Bankën, të regjistruar dhe llogarive për vitin financiar paraprakisë;

d) në ose para 31 marsit 2008, përgatit një plan biznesi për pesë vitet në vazhdim dhe e përditëson planin e biznesit në çdo 31 mars pas kësaj për pesë vitet në vazhdim, duke përfshirë informacionin e rregullt mbi privatizimin e mundshëm të pjesëve të aktiviteteve të Huamarrësit; dhe

e) zbaton dhe merr masa që aksionarët e tij të zbatojnë një politikë dividendësh, në bazë të së cilës ai mban minimalisht 80% të fitimeve neto për çdo vit fiskal.

Seksioni 3.02 Njësia e zbatimit të projekteve

Me qëllim që të koordinojë, menaxhojë, monitorojë dhe vlerësojë të gjitha aspektet e zbatimit të projektit, duke përfshirë prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të projektit, Huamarrësi, nëse nuk bihet dakord ndryshe me Bankën, ngre dhe operon gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të projektit një njësi zbatimi me burimet e nevojshme dhe personel të kualifikuar në masën e mjaftueshme, me kushtet e referencës të pranueshme për Bankën.

Seksioni 3.03 Prokurimi

Për qëllimet e seksionit 4.03 të termave dhe kushteve standarde, dispozitat e mëposhtme, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe, rregullojnë prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe që financohet nga shuma e huasë:

a) Mallrat, punimet dhe shërbimet prokurohen me tenderim të hapur.

b) Për qëllimet e seksionit 3.03(a), procedurat për tenderimin e hapur, tenderimin përzgjedhës, tenderimin dhe blerjet e vetme, dhe standardet për procedurat lokale konkurruese të tenderimit janë parashikuar në kapitullin e rregullave të prokurimit të EBRD-së.

c) Të gjitha kontratat i nënshtrohen procedurave të rishikimit të parashikuara në shtojcën 1 të rregullave të prokurimit të EBRD-së. Të gjitha kontratat i nënshtrohen rishikimit paraprak.

Seksioni 3.04 Kushtet e ambientit dhe kushtet sociale

Pa kufizuar përgjithësimin e seksioneve 4.02(a), 4.04(a)(iii) dhe 5.02(c)(iii) të termave dhe kushteve standarde, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe, Huamarrësi:

a) nëse nuk është përcaktuar ndryshe në planin e veprimit të ambientit, e zbaton projektin në pajtim me: (i) rregullat dhe standardet e ambientit që janë në fuqi për kohën në Republikën e Shqipërisë, (ii) standardet e ambientit që ekzistojnë në Bashkimin Europian në datën e tyre (ose, në rast se këto standarde nuk ekzistojnë në Bashkimin Europian, sipas parashikimit në udhëzimet e zbatueshme për ambientin të Grupit të Bankës Botërore), (iii) udhëzimet e IFC-së për ambientin, shëndetin dhe sigurinë për portet, limanet dhe terminalët (2006) dhe (iv) standardet e Organizatës Ndërkombëtare Detare (dhe udhëzimet) për sigurinë dhe ambientin në det;

b) respekton të gjitha ligjet dhe standardet e zbatueshme për punësimin, duke përfshirë ato në lidhje me punësimin e fëmijëve dhe të rinjve, diskriminimin në punë dhe punën e detyruar. Këto ligje dhe standarde të zbatueshme përfshijnë: (i) konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me heqjen e punës së fëmijëve, eliminimin e diskriminimit në vendin e punës dhe eliminimin e

punës së detyruar dhe të detyrueshme dhe (ii) të drejtën e brendshme, dhe

c) zbaton dhe respekton vazhdimisht planin e punës për ambientin.

Seksioni 3.05 Kërkesat për paraqitjen dhe shpeshësinë e raportimit

a) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, derisa shuma e plotë e huasë të jetë shlyer ose anuluar, Huamarrësi i paraqet Bankës raporte vjetore për çështjet e ambientit dhe çështjet sociale që lindin në lidhje me Huamarrësin ose projektin, sipas referencës së seksionit 5.02(c)(iii) të termave dhe kushteve standarde, brenda 90 ditëve pas përfundimit të vitit për të cilin bëhet raportimi. Këto raporte përfshijnë informimin në lidhje me çështjet specifike të mëposhtme:

1. informacionin mbi respektimin nga Huamarrësi në lidhje me kërkesat për ambientin, shëndetin, sigurinë dhe kërkesat sociale të përcaktuara në seksionin 3.04, duke përfshirë statusin e çdo leje ambienti të kërkuar për projektin, rezultatet e inspektimeve të kryera nga autoritetet rregulluese, çdo shkelje të ligjeve, rregulloreve dhe standardeve të zbatueshme dhe çdo veprim zhdëmtues për këto dhe çdo gjohë të vënë për këto shkelje;

2. informacion mbi zbatimin e planit të veprimit të ambientit, duke përfshirë çdo ndryshim të propozuar për veprimet, afatet kohore dhe shpenzimet;

3. një përmbledhje të të gjitha njoftimeve, raporteve dhe komunikimeve materiale mbi çështjet e ambientit ose çështjet sociale të paraqitura nga Huamarrësi çdo autoriteti rregullues;

4. informacion mbi gjendjen shëndetësore dhe të sigurisë në projekt, duke përfshirë shkallën e aksidenteve dhe çdo iniciativë në lidhje me çështjet shëndetësore dhe të sigurisë që janë zbatuar ose planifikuar nga Huamarrësi;

5. një përmbledhje të çdo ndryshimi në ligjet për ambientin, shëndetin dhe sigurinë që kanë një efekt material mbi operacionet e Huamarrësit ose projektin; dhe

6. kopje të informacionit mbi çështjet e ambientit ose çështjet sociale që u paraqiten periodikisht nga Huamarrësi aksionarëve ose publikut të gjerë.

b) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, Huamarrësi paraqet raporte periodike për projektin, të përmendura në seksionin 4.04(a)(iv) të termave dhe kushteve standarde çdo tre muaj, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit deri në përfundimin e projektit. Këto raporte përfshijnë tiparet specifike të mëposhtme:

1. informacionin e përgjithshëm të mëposhtëm:

A) progresin fizik të bërë në zbatimin e projektit në datën e raportimit gjatë periudhës së raportimit;

B) vështirësitë e tashme ose të pritshme apo vonesat në zbatimin e projektit dhe efektet e tyre në afatet e zbatimit dhe masat e tashme të marra ose të planifikuara për zbatimin e vështirësive dhe për të shmangur vonesat;

C) ndryshimet e pritshme në datën e përfundimit të projektit;

D) ndryshimet e rëndësishme në personelin e PIU-t, konsulentëve ose kontraktorëve;

E) çështjet që mund të ndikojnë në shpenzimet e projektit; dhe

F) çdo zhvillim ose aktivitet që mund të ndikojë në qëndrueshmërinë ekonomike të çdo pjese të projektit.

2. Një tabelë progresi, bazuar në planin kohor të zbatimit të projektit, që tregon progresin e secilës pjesë të projektit dhe duke përfshirë një grafik për shpenzimet faktike dhe të planifikuara.

3. Deklarimet financiare që tregojnë detajet e shpenzimeve që janë shkaktuar në çdo pjesë të projektit dhe tërheqjet, së bashku me një deklaram, që tregon:

A) parashikimet e shpenzimeve fillestare;

B) parashikimet e shpenzimeve të rishikuara, nëse ka, me arsyet për ndryshimet;

C) shpenzimet fillestare të parashikuara dhe shpenzimet faktike deri në atë datë;

D) arsyet për diferencat e shpenzimeve faktike deri atë datë nga shpenzimet fillestare të parashikuara deri tani; dhe

E) shpenzimet e parashikuara për tremujorët e mbetur të vitit.

c) Menjëherë me ndodhjen e ndonjë incidenti ose aksidenti në lidhje me Huamarrësin ose projektin që mund të ketë një ndikim material në ambient, shëndet ose siguri, Huamarrësi njofton për këtë Bankën me faks ose teleks, ku tregohet natyra e këtij incidenti ose aksidenti dhe hapat që po ndërmer Huamarrësi për rregullimin përkatës. Pa kufizuar përgjithësimin sa më sipër, një incident ose aksident mund të ketë një ndikim material negativ në ambient, shëndet ose siguri, nëse një ligj i zbatueshëm kërkon njoftimin e këtij incidenti ose aksidenti tek një autoritet qeveritar, ky incident ose

aksident sjell efekte të pakthyeshme ose dëmtime të shumta serioze që kërkojnë shtrim në spital, ose ky incident apo aksident është bërë publik nëpërmjet mbulimit nga media ose ndryshe.

Neni 4

Kushte financiare dhe operative

Seksioni 4.01 Regjistrat dhe raportet financiare

a) Huamarrësi mban procedura, regjistra dhe llogari të përshtatshme për të reflektuar në pajtim me standardet e llogarive ndërkombëtarisht të pranuar, gjendjen operative dhe financiare të Huamarrësit dhe filialeve të tij, nëse ka, dhe të përshtatshme për të monitoruar dhe regjistruar përparimin e projektit (duke përfshirë shpenzimet dhe përfitimet që rrjedhin prej tij).

b) Huamarrësi:

1. realizon auditimin e regjistrave, llogarive dhe pasqyrave financiare (duke përfshirë bilancin, pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrën e ndryshimeve në gjendjen financiare, dhe shënimet në to) dhe të regjistrave, llogarive dhe pasqyrave financiare të filialeve të tij në çdo vit fiskal nga auditues të pavarur të pranueshëm për Bankën në pajtim me IFRS-në;

2. i jep Bankës sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të çdo viti fiskal:

A) kopje të vërtetuara të pasqyrave financiare për këtë vit fiskal që është audituar;

B) raportin e këtij auditimi nga këta auditues me atë objekt dhe ato detaje që mund të kërkoen në mënyrë të arsyeshme nga Banka; dhe

C) një pasqyrë të transaksioneve financiare ndërmjet Huamarrësit dhe çdo filiali të tij; dhe

3) i jep Bankës çdo informacion tjetër në lidhje me këto regjistra, llogari dhe pasqyra financiare, dhe auditimin e tyre, siç mund të kërkoen nga Banka herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

Seksioni 4.02 Kushte financiare mohuese

a) Huamarrësi, nëse nuk bie dakord ndryshe me Bankën, nuk ndërmerr asnjë nga veprimet e mëposhtme dhe i jep Bankës të gjithë informacionin për këtë që mund të kërkoet në mënyrë të arsyeshme nga Banka:

1. përfundimi i një marrëveshjeje ose mase për të garantuar në ndonjë mënyrë ose me ndonjë kusht për të marrë përsipër pjesërisht ose plotësisht një detyrim financiar apo tjetër të një personi tjetër, duke përfshirë çdo filial;

2. përfundimi i një veprimi me një person tjetër përveçse gjatë kryerjes së zakonshme të punës, me kushte të zakonshme të tregtisë dhe mbi bazën e masave të zakonshme apo ngritja e një agjencie të vetme dhe përjashtuese blerjesh ose shitjesh, apo përfundimi i një veprimi nëpërmjet të cilit Huamarrësi mund të paguajë më shumë se çmimi tregtar i zakonshëm për çdo blerje ose mund të marrë më pak se çmimi tregtar me punë të mbaruar (nënshtruar skontove të zakonshme tregtare) për produktet ose shërbimet e tij;

3. përfundimi i ortakërive, marrëveshjeve për ndarjen e fitimit ose tarifave të licencave ose masë tjetër të ngjashme me anë të së cilës të ardhurat ose fitimet e Huamarrësit ndahen ose mund të ndahen me një person tjetër;

4. (qoftë vullnetarisht ose jo) bërja e çdo parapagimi, riblerjeje apo shlyerjeje e parakohshme e çdo borxhi ose bërja e një shlyerjeje të një borxhi në pajtim me një dispozitë të një marrëveshjeje ose shënimi që parashikon drejtpërdrejt ose jo përshtetimin e shlyerjes në kohë ose shume, përveç kur në një rast të tillë, nëse Banka e kërkon këtë, Huamarrësi njëkohësisht bën një shlyerje proporcionale të shumës principale të papaguar të huasë në pajtim me dispozitat e seksionit 3.07 të termave dhe kushteve standarde (me kusht që shuma e një parapagimi të tillë nuk u nënshtrohet kërkesave të shumës minimale të parapagimit);

5. shitja, transferimi, lëshimi me qira apo disponimi ndryshe i të gjitha sendeve pasurore ose një pjese thelbësore të tyre (qoftë në një transaksion të vetëm ose në një seri transaksionesh, të lidhur ose jo); ose

6. marrja përsipër ose lejimi i një shkrirjeje, përqendrimi ose riorganizimi.

b) Huamarrësi, nëse nuk informon Bankën të paktën 30 ditë më parë, nuk ndërmerr asnjë nga

veprimet e mëposhtme dhe i jep Bankës të gjithë këtë informacion që Banka mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme:

1. përfundimi i një kontrate menaxhimi ose një mase tjetër të ngjashme, nëpërmjet së cilës aktiviteti ose veprimet menaxhohen nga një person tjetër, duke përfshirë çdo Filial; ose

2. formimi i një filiali, ose dhënia apo lejimi i ekzistencës së huave, parapagesave ose depozitave (përveç depozitave gjatë ushtrimit të zakonshëm të aktivitetit me banka të njohura) te persona të tjerë ose investime te një person, duke përfshirë çdo filial; me kusht që Huamarrësi të jetë i lirë të investojë në letra me vlerë të tregtueshme të shkallës së investimit afatshkurtër vetëm për të zënë përkohësisht me punë burimet e pashfrytëzuara të Huamarrësit.

Seksioni 4.03 Kushte të tjera financiare

Pa kufizuar përgjithësimin e seksionit 4.02, Huamarrësi, në datën e parë të shlyerjes së huasë, dhe në çdo datë të mëvonshme, mban raportin e:

a) fluksit të parasë që vjen nga aktivitetet operative për 12 muajt para datës së llogaritjes, duke i shtuar interesin e paguar gjatë kësaj periudhe, minus ato flukse parash për këtë periudhë që janë zbatuar gjatë periudhës për përfundimin e sendeve pasurore afatgjata; me

b) shumën e shlyerjeve të shumës principale dhe pagesat e interesit të kërkueshme gjatë 12 muajve pas datës së llogaritjes,

jo më pak se 1.2:1, ku termat e përdorura në këtë seksion 4.03 interpretohen në pajtim me IFRS-në.

Seksioni 4.04 Kryerja e aktivitetit dhe veprimeve

Huamarrësi, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe:

a) e kryen aktivitetin dhe veprimet e tij në pajtim me standardet dhe praktikën e njohura ndërkombëtarisht të shëndosha administrative, financiare, inxhinierike dhe të tjera, duke u kushtuar vëmendje politikave operative kryesore;

b) merr menjëherë të gjitha masat brenda kompetencave të tij për të ruajtur ekzistencën e tij ligjore, të kryejë aktivitetin e tij dhe të përftojë, mbajë dhe rinovojë të gjitha të drejtat, pasuritë, kompetencat dhe privilegjet që janë të nevojshme për kryerjen e aktivitetit, duke përfshirë zbatimin e projektit;

c) nuk shet, lëshon me qira ose disponon ndryshe mbi ndonjë nga sendet e tij pasurore që janë përfutur për zbatimin me efikasitet të operacioneve të tij dhe disponimi i të cilit mund të cenojë aftësinë e tij për të përmbushur në mënyrë të pranueshme ndonjë nga detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje;

d) njofton menjëherë Bankën për çdo propozim për të ndryshuar, pezulluar apo anuluar ndonjë dispozitë të statuteve dhe i jep Bankës mundësi të përshtatshme për të komentuar në lidhje me këto propozime, para se të ndërmarrë ndonjë veprim për to;

e) lidh dhe mban me sigures të përgjegjshëm, ose merr për këtë masa të tjera të pranueshme për Bankën, siguracion ndaj rrezikut të humbjes, dëmtimit dhe detyrimit dhe me shumën të tilla që të jenë në pajtim me praktikën e përshtatshme; dhe

f) gjithmonë operon dhe mban ambientet, impiantet dhe pajisjet, dhe sendet e tjera pasurore në gjendje të mirë pune dhe në kohën e duhur, bën të gjitha riparimet dhe rinovimet, në pajtim me praktikën e shëndosha të biznesit dhe ato financiare.

Neni 5

Pezullimi, përsheptimi, anulimi

Seksioni 5.01 Pezullimi

Elementet e mëposhtme janë përcaktuar për qëllimet e seksionit 7.01(a)(xvii) të termave dhe kushteve standarde:

a) Kuadri ligjor dhe rregullator i zbatueshëm për portet dhe sektorin e transportit detar në territorin e Garantuesit janë ndryshuar, pezulluar ose abroguar, anuluar ose hequr dorë, në mënyrë të tillë që ndikojnë negativisht dhe materialisht në operacionet ose gjendjen financiare të Huamarrësit ose aftësinë e tij të përmbushë detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose të zbatojë projektin sipas parashikimit nga kjo Marrëveshje;

b) Disponibiliteti për Huamarrësin ose Garantuesin, sipas rastit, i huasë së EIB-së ose i fondeve të grantit të BE-së është pezulluar, anuluar ose ka pushuar plotësisht ose pjesërisht, në pajtim me termat e masave përkatëse; megjithatë, me kusht që dispozitat e këtij paragrafi nuk zbatohen nëse Huamarrësi i

provon në mënyrë bindëse Bankës që grantet ose huatë koncesionare të mjaftueshme për dhe siguruar fonde të përshtatshme për projektin, i ofrohen Huamarrësit nga burime të tjera brenda termave dhe kushteve, në pajtim me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

c) Kontrolli i Huamarrësit i është transferuar një pale të ndryshme nga qeveria qendrore e Republikës së Shqipërisë.

Seksioni 5.02 Përshpejtimi i maturimit

Elementet e mëposhtme janë përcaktuar për qëllimet e seksionit 7.06(f) të termave dhe kushteve standarde: çdo ngjarje e përcaktuar në seksionin 5.01 ka zgjatur për 30 ditë pas njoftimit të bërë nga Banka Huamarrësit për konstatimin nga Banka se kjo ngjarje ka ndodhur, duke përcaktuar atje vullnetin e Bankës për të vepruar në pajtim me kushtet e seksionit 7.06 të termave dhe kushteve standarde.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Seksioni 6.01 Parakushtet e hyrjes në fuqi

Elementet e mëposhtme përcaktohen për qëllimet e seksionit 9.02(c) të termave dhe kushteve standarde si kushte shtesë për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjen e garancisë:

a) Marrëveshja e garancisë dhe sipas rastit, kjo Marrëveshje, janë ratifikuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë;

b) themelohet PIU;

c) Plani i veprimit në ambient është miratuar në lidhje me pjesën 1 të projektit;

d) një konsulent mbikëqyrës është emëruar me personelin dhe termat e referencës të pranueshme për Bankën për të monitoruar të gjitha aspektet e zbatimit të punimeve të pjesës 1 të projektit; dhe

e) janë marrë të gjitha lejet e nevojshme për ambientin dhe ndërtimin për zbatimin e pjesës 1 të projektit.

Seksioni 6.02 Mendimet ligjore

a) Për qëllimet e seksionit 9.03(a) të termave dhe kushteve standarde, mendimi ose mendimet e këshillimit jepen në emër të Huamarrësit nga shefi i departamentit ligjor të Huamarrësit.

b) Për qëllimet e seksionit 9.03(b) të termave dhe kushteve standarde, mendimi ose mendimet e këshillimit jepen në emër të Garantuesit nga Ministri i Drejtësisë.

Seksioni 6.03 Prishja për shkak të moshyrjes në fuqi

Data 90 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e seksionit 9.04 të termave dhe kushteve standarde.

Neni 7

Të ndryshme

Seksioni 7.01 Njoftime

Adresat e mëposhtme përcaktohen për qëllimet e seksionit 10.01 të termave dhe kushteve standarde:

Për Huamarrësin:

Autoriteti i Portit të Durrësit

Lagja Nr. 1, Rruga Tregtare

Durrës

Republika e Shqipërisë

Drejtuar: Drejtorit Ekzekutiv

Fax: + 355 5 223 115

Për Bankën:

European Bank for Reconstruction and Development

One Exchange Square

London EC2A 2JN
United Kingdom
Drejtuar: Operation Administration Unit (Opid 35862)
Fax: + 44 20 7338 6100
Telex: 8812161
Answerback: EBRD L G

Në dëshmi të kësaj, Palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë bërë nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje në katër kopje dhe dërgimin në Tiranë, Republika e Shqipërisë në ditën dhe vitin e treguar më sipër.

Autoriteti i Portit të Durrësit
Nga: _____
Emri
Titulli

Banka Europiane
Për Rindërtim dhe Zhvillim
Nga: _____
Emri
Titulli

PLANI KOHOR 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i projektit është të asistojë Huamarrësin në ndërtimin e një terminali të ri tragetesh dhe rehabilitimin e infrastrukturës përkatëse në Portin e Durrësit.

2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, që u nënshtrohen ndryshimeve për të cilat Banka dhe Huamarrësi mund të bien dakord herë pas here:

Pjesa 1: Ndërtimi i një terminali të ri tragetesh dhe infrastrukturës ndihmëse.

Pjesa 2: Rehabilitimi i platformës 7 dhe 8

Punimet për pjesën 1 dhe 2 më sipër, duke përjashtuar taksat, do të bashkëfinancohen me shumat nga huaja e EIB-it. Huamarrësi do të financojë të gjitha taksat në lidhje me kontratat e punimeve, sipas rastit. Nëse shumat nga huaja nuk janë të mjaftueshme për të financuar kontratat e punimeve për pjesën 1 dhe 2, Huamarrësi do të financojë punimet që mbeten për të siguruar përfundimin e projektit me burimet e veta.

Pjesa 3: Mbikëqyrja e punimeve për pjesën 1 dhe 2 të projektit

Konsulentët e mbikëqyrjes do të caktohen për të monitoruar zbatimin e punimeve sipas pjesës 1 dhe 2 të projektit. Këto shërbime do të financohen:

a) në rastin e konsulentit për pjesën 1 të projektit, nga fondet e grantit të BE-së; dhe

b) në rastin e konsulentit për pjesën 2 të projektit, nga fondet e grantit të BE-së ose huaja e EIB-it ose fonde të tjera që mund t'i ofrohen Huamarrësit.

3. Projekti parashikohet të përfundojë më 31 dhjetor 2010.

PLANI KOHOR 2 KATEGORITË DHE TËRHEQJET

1. Tabela e bashkangjitur këtij plani kohor përcakton kategoritë, shumën e huasë, të caktuar secilës kategorie dhe përqindjen e shpenzimeve që financohen në secilën kategori.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të mësipërm, asnjë tërheqje nuk bëhet në lidhje me shpenzimet e kryera para datës së Marrëveshjes së huasë.

SHTOJCË PËR PLANIN KOHOR 2

| Kategoria | Shuma e huasë dhënë në monedhën e huasë | Përqindja e shpenzimeve për financim |
|--------------------------------------|---|--|
| 1. Punimet për pjesën 1 të projektit | 10, 560, 000 euro | 50% e vlerës së kontratës, duke përjashtuar taksat |
| 2. Punimet për pjesën 2 të projektit | 3, 300, 000 euro | 50% e vlerës së kontratës, duke përjashtuar taksat |
| 3. Komisioni i fazës fillestare | 140, 000 euro | 100% e komisionit të fazës |

| | | |
|--------------|-------------------|-------------------------|
| të projektit | | fillestare të projektit |
| Totali | 14, 000, 000 euro | |

LIGJ
Nr.9759, datë 21.6.2007

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR
ZHVILLIM (IDA) PËR PROGRAMIN E FAZËS SË PARË TË HUASË,
NË MBËSHTETJE TË POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për programin e fazës së parë të huasë, në mbështetje të politikave të zhvillimit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5380, datë 26.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

Departamenti ligjor
Tekst i negociuar
(I nënshtrohet ndryshimit)
K. Propst
16 shkurt, 2007

NUMRI KREDISË -

MARRËVESHJE FINANCIMI
(OPERACIONI I PARË I POLITIKËS SË ZHVILLIMIT)
NDËRMJET SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM
Datë , 2007

Marrëveshje e datës __, 200-, e lidhur ndërmjet Shqipërisë (Përfituesi) dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (Shoqata), me qëllim sigurimin e financimit në mbështetje të programit (sipas përkufizimit të shtojcës në këtë Marrëveshje). Shoqata ka vendosur ta japë këtë financim mbi bazën, ndërmjet të tjerash, të: (a) veprimeve që Përfituesi tashmë ka ndërmarrë sipas programit dhe që janë përshkruar në seksionin I të planit kohor 1 të kësaj Marrëveshjeje; dhe (b) mbajtjes nga Përfituesi të një kuadri politik të përshtatshëm makroekonomik. Përfituesi dhe Shoqata bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushte të përgjithshme, përkufizime

1.01 Kushtet e përgjithshme (sipas përcaktimit në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) përbëjnë një pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat me germa të mëdha të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u jepen atyre në kushtet e përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2 **Financimi**

2.01 Shoqata bie dakord t'i japë Përfituesit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të referuara në këtë Marrëveshje, një kredi në një shumë të barasvlefshme me gjashtë milion e tetëqind mijë të drejta të veçanta tërheqjeje (SDR 6 800 000) (variabël "Kredi" dhe "Financim").

2.02 Përfituesi mund të tërheqë shumën e financimit në mbështetje të programit, në pajtim me seksionin II të planit kohor 1 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa maksimale e zotimit financiar, e pagueshme nga Përfituesi mbi Balancën Financiare të Patërhequr është gjysma e një për qind (1/2 e 1%) në vit.

2.04 Tarifa e shërbimit e pagueshme nga Përfituesi mbi balancën e tërhequr të kredisë është e barabartë me tre të katërtat e një për qind (3/4 e 1%) në vit.

2.05 Datat e pagesës janë 1 prilli dhe 1 tetori i çdo viti.

2.06 Shuma principale e kredisë shlyhet në pajtim me afatet e shlyerjes, të caktuara në planin kohor 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.07 Monedha e pagesës është euro.

Neni 3 **Programi**

3.01 Përfituesi deklaron zotimin e tij financiar për programin dhe zbatimin e tij. Për këtë qëllim:

a) Përfituesi dhe Shoqata, herë pas here dhe me kërkesën e njërës Palë, shkëmbejnë mendime në lidhje me progresin e bërë gjatë zbatimit të programit;

b) para secilit shkëmbim mendimesh, Përfituesi i paraqet Shoqatës për rishikim dhe koment një raport mbi përparimin e bërë gjatë zbatimit të programit, të detajuar në masën që kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Shoqata; dhe

c) pa u kufizuar në dispozitat e paragrafëve (a) dhe (b) të këtij seksioni, Përfituesi shkëmben mendime me Shoqatën në lidhje me çdo veprim të propozuar që duhet të merret pas disbursimit të financimit që do të kishte efektin e ndryshimit material të objektivave të programit, apo çdo veprim tjetër të ndërmarrë sipas programit, duke përfshirë çdo veprim të përcaktuar në seksionin I të planit kohor 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4 **Mjetet e mbrojtjes për Shoqatën**

4.01 Ngjarja shtesë e pezullimit do të thotë kryesisht që është krijuar një situatë që e bën të papërshtatshëm zbatimin e programit ose një pjesë të rëndësishme të tij.

4.02 Ngjarja shtesë e përshpejtimit do të thotë kryesisht që ngjarja e përcaktuar në seksionin 4.01 të kësaj Marrëveshjeje ndodh dhe vazhdon për një periudhë prej 60 ditësh pas njoftimit të ngjarjes të bërë Përfituesit nga Shoqata.

Neni 5 **Hyrja në fuqi**

5.01 Data e hyrjes në fuqi është nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6 **Përfaqësuesi, adresat**

6.01 Përfaqësuesi i Përfituesit është Ministria e Financave.

6.02 Adresa e Përfituesit është:

Ministria e Financave
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit"
Tirana, Albania
Faksimile:
+3554228494

6.03 Adresa e Shoqatës është:

Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America
Adresa kabllore: Teleks: Faksimile:
INDEVAS 248423(MCI) 1-202-477-6391
Washington, D.C.

Rënë dakord në,..... data dhe viti i shkruar më sipër.

Shqipëria
nga
Përfaqësuesi i autorizuar

Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim
nga
Përfaqësuesi i autorizuar

PLANI KOHOR 1 VEPRIMET E PROGRAMUARA, DISPONIBILITETI I TË ARDHURAVE FINANCIARE

Seksioni I. Veprimet në bazë të programit

Veprimet e ndërmarra në bazë të programit.

Veprimet e ndërmarra nga Përfituesi në bazë të programit përfshijnë sa më poshtë:

1. Përfituesi ka përfunduar një rishikim dhe përgatitur rekomandimet për eliminimin e kërkesave të tepërta për licencim në sektorët e hidrokarbonit, minierave, peshkimit, punëve publike, shëndetësisë, arsimit, bujqësisë, mjedisit, pylltarisë, administrimit të ujërave, mbrojtjes nga zjarri, doganave, ndërtimit dhe transportit.

2. Është miratuar një ligj i ri për koncesionet, që parashikon një sistem transparent dhe tërësisht konkurrues për ofertat dhe ndryshimet për rregullat zbatuese, të pranueshme për Shoqatën, janë miratuar përkatësisht nga Këshilli i Ministrave ose Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Është miratuar legjislacioni për ngritjen e një rregullatori të integruar financiar jobankar.

4. Është miratuar një ligj për prokurimin publik, që parashikon një rishikim të përmirësuar të ankesave, realizon tendera të hapur si procedurë e vetme, që i jep statusin e nëpunësit të shërbimit civil kreut të Agjencisë së Prokurimit Publik (PPA), që rrit zbatueshmërinë e kontraktimit disavjeçar dhe që jep mandat për publikimin e dokumenteve të tenderit dhe rezultatet me bazë kohore.

5. Përfituesi ka marrë masa, të pranueshme për Shoqatën, për të ndaluar deficitin e Institutit të Sigurimeve Shëndetësore dhe kufizuar shpenzimet farmaceutike.

6. Përfituesi ka bërë progres, të pranueshëm për Shoqatën, në lidhje me procedurat dhe praktikat e menaxhimit të përmirësuar publik për investimet.

7. Përfituesi ka dhënë prova, të pranueshme për Shoqatën, në lidhje me qëndrueshmërinë e veprimeve të caktuara për personelin që përfshihen në objektin e ligjit për shërbimin civil, legjislacionin e tij dytësor dhe rregullave që rregullojnë menaxhimin e burimeve njerëzore të nëpunësve të shërbimit civil në pozicionet qendrore qeveritare.

Seksioni II. Disponibiliteti i të ardhurave financiare

A. Të përgjithshme. Përfituesi mund të tërheqë shumat e financimit në pajtim me dispozitat e këtij seksioni dhe udhëzimet e tjera shtesë që Shoqata mund t'i përcaktojë duke njoftuar Përfituesin.

B. Alokimi i shumave financiare. Financimi tërhiqet në një transh të vetëm.

C. Depozitimi i shumave financiare. Nëse Shoqata nuk bie dakord ndryshe:

1. Të gjitha tërheqjet nga llogaria financiare depozitohen nga Shoqata në një llogari të caktuar nga Përfituesi dhe të pranueshme për Shoqatën; dhe

2. Përfituesi siguron që për çdo depozitim të një shume financimi në këtë llogari, të futet në sistemin e menaxhimit të buxhetit të Përfituesit një shumë e barasvlefshme në një mënyrë të pranueshme

për Shoqatën.

D. Shpenzimet e përjashtuara. Përfituesi merr përsipër që të ardhurat e financimit të mos përdoren për financimin e shpenzimeve të përjashtuara. Nëse Shoqata përcakton në çdo kohë që një shumë e financimit është përdorur për të bërë një pagesë për një shpenzim të përjashtuar, Përfituesi, menjëherë pas njoftimit të Shoqatës, e rimbursos shumën e barabartë me shumën e një pagese të tillë për Shoqatën. Shumat e rimbursuara Shoqatës me një kërkesë të tillë anulohen.

E. Data e përfundimit. Data e përfundimit është 31 dhjetor 2007.

AFATI KOHOR 2

| | |
|---|---|
| Data e kërkueshmërisë së pagesës | Shuma principale e kredisë së shlyeshme (shprehur në përqindje) |
| Në çdo 1 prill dhe 1 tetor duke filluar nga 1 prilli 2017 dhe duke përfshirë 1 tetorin 2026 | 5% |

*Përqindjet përfaqësojnë përqindjen e shumës principale të kredisë që duhet shlyer, përveç rasteve kur Shoqata mund të përcaktojë ndryshe, në pajtim me seksionin 3.03(b) të kushteve të përgjithshme.

SHTOJCË

Seksioni I, përkufizime

1. "Shpenzime të përjashtuara" është çdo shpenzim:

a) për mallra dhe shërbime që jepen në bazë të një kontrate që ka financuar ose ka rënë dakord të financojë në bazë të një kontrate çdo institucion ose agjenci ndërkombëtare financiare, të ndryshme nga Shoqata, ose që Shoqata apo Banka ka financuar ose pranuar të financojë nën një kredi, grant ose hua tjetër;

b) për mallrat e përfshira në grupet ose nëngrupet e mëposhtme të Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Tregtisë, rishikimi 3 (SITC, Rev. 3), publikuar në Kombet e Bashkuara në dokumentet statistikore, seritë M, Nr 341Rev 3 (1986) (SITC), ose çdo grup apo nëngrup pasues nën rishikimet e ardhshme në SITC, sipas përcaktimit nga Shoqata, duke njoftuar Përfituesin:

| Grupi | Nëngrupi | Përshkrimi i artikullit |
|-------|----------|--|
| 112 | | Pijet alkoolike |
| 121 | | Duhan, i papërpunuar, mbeturina duhani |
| 122 | | Duhan, i përpunuar (që përmban ose jo zëvendësues duhani) |
| 525 | | Materiale radioaktive dhe të lidhura me to |
| 667 | | Perla, gurë të çmuar dhe gjysmë të çmuar, të papërpunuar ose të përpunuar |
| 718 | 718.7 | Reaktorë bërthamorë dhe pjesë të tyre, elemente të karburanteve (kuti), i parrezatuar, për reaktorë bërthamorë |
| 718 | 728.43 | Makineri për përpunimin e duhanit |
| 897 | 897.3 | Sende të çmuara të metaleve të grupit të arit, argjendit ose platinës (përveç orëve dhe kutive të orëve) dhe mallra të ar dhe argjendpunuesve (duke përfshirë gurët e çmuar) |
| 971 | | Ar, jomonetar (duke përfshirë mineralet dhe përqendrimit e arit) |

c) për mallrat e destinuara për një qëllim ushtarak ose paraushtarak, ose për konsum luksoz;

d) për mallrat e rrezikshëm, ambienti, prodhimi, përdorimi ose importimi i të cilëve është ndaluar nga ligjet e Përfituesit ose marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Përfituesi është Palë;

e) për llogari të një pagese të ndaluar, me vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të marrë sipas kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara; dhe

f) në bazë të një kontrate në lidhje me të cilën Shoqata përcakton që kanë qenë përfshirë praktika korruptive, mashtruese, të fshehta ose detyruese nga përfaqësuesit e Përfituesit ose përfitues të tjerë të të ardhurave financiare gjatë prokurimit ose ekzekutimit të këtyre kontratave, dhe Përfituesi (ose një përfitues tjetër) nuk ka marrë masat në kohë dhe të përshtatshme, të pranueshme për Shoqatën për të ndrequr situatën.

2. “Kushte të përgjithshme” janë “Kushtet e përgjithshme të Shoqatës Ndërkombëtare për zhvillim për kreditë dhe grantet”, e datës 1 korrik, 2005 me modifikimet e përcaktuara në seksionin II të kësaj shtojce.

3. “Instituti i Sigurimeve Shëndetësore” është Instituti i Sigurimeve Shëndetësore i ngritur në pajtim me ligjin nr. 7870, datë 13 tetor 1994.

4. “Program” është programi i veprimeve, objektivave dhe politikave të caktuara për të nxitur rritjen e reduktimeve të qëndrueshme të varfërisë dhe të përcaktuar ose referuar në letrën e datës _____ nga Përfituesi drejtuar Shoqatës që deklaron zotimin financiar të Përfituesit për ekzekutimin e programit dhe që kërkon asistencë nga Shoqata në mbështetje të programit gjatë zbatimit të tij.

5. “Agjencia e prokurimit publik” ose PPA është subjekti i përmendur në nenin 13 të ligjit nr.9643 të datës 20 nëntor 2006.

6. “Transh i vetëm” është shuma e financimit të përmendur në pjesën B të seksionit II të planit kohor 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni II. Ndryshimet e kushteve të përgjithshme

Ndryshimet e “Kushteve të përgjithshme të Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim për kreditë dhe grantet” e datës 1 korrik, 2005 janë si më poshtë:

1. Fjalja e fundit e paragrafit (a) e seksionit 2.03 (në lidhje me aplikimet për tërheqje) fshihet e gjitha.

2. Seksioni 2.04 (Llogaritë e përcaktuara) dhe 2.05 (Shpenzimet e përshtatshme) fshihen të gjitha, dhe seksionet që mbeten në nenin II rinumërtohen përkatësisht.

3. Seksionet 4.01 (Ekzekutimi i projektit në përgjithësi) dhe 4.09 (Menaxhimi financiar, deklaratimet financiare, auditimet) fshihen tërësisht, dhe seksionet që mbeten në nenin IV rinumërtohen përkatësisht.

4. Paragrafi (a) i seksionit 4.05 (i rinumërtuar si i tillë në pajtim me paragrafin 3 të mësipërm dhe në lidhje me përdorimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve) fshihet tërësisht.

5. Paragrafi (c) i seksionit 4.06 (i rinumërtuar si i tillë në pajtim me paragrafin 3 të mësipërm) ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“Seksioni 4.06 Planet, dokumentet, regjistrat

c) Përfituesi mban të gjitha regjistrat (kontratat, urdhrat, faturat, dhe dokumente të tjera) që provojnë shpenzimet sipas financimit deri në dy vjet pas datës së përfundimit. Përfituesi i jep mundësi përfaqësuesit të Shoqatës të inspektojë këto regjistra.”

6. Seksioni 4.07 (i rinumërtuar në pajtim me paragrafin 3 të mësipërm) ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

Seksioni 4.07 Monitorimi dhe vlerësimi i programit

c) Përfituesi përgatit ose merr masa për përgatitjen dhe dhënien Shoqatës jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së përfundimit, një raport me atë objekt dhe ato detaje që mund të kërkohej në mënyrë të arsyeshme nga Shoqata, për zbatimin e programit, përmbushjen nga Përfituesi dhe Shoqata të detyrimeve të tyre përkatëse, në bazë të marrëveshjeve ligjore dhe arritjen e qëllimeve të financimit.

7. Termat dhe përkufizimet e mëposhtme të përcaktuara në shtojcë ndryshohen ose fshihen si më poshtë dhe termat dhe përkufizimet e reja të mëposhtme shtohen në rendin alfabetik në shtojcë si më poshtë, ku termat rinumërtohen përkatësisht:

(a) Përkufizimi i termit “Shpenzim i përshtatshëm” ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“Shpenzim i përshtatshëm” është çdo përdorim i financimit në mbështetje të programit, i ndryshëm nga shpenzimet financiare të përjashtuara në pajtim me Marrëveshjen e financimit.”

b) Termi “Deklarime financiare” dhe përkufizimi i tij i përcaktuar në shtojcë fshihet tërësisht.

c) Termi “Projekt” ndryshohet me fjalën “Program” dhe përkufizimi i tij ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“Program” është programi i përmendur në Marrëveshjen e financimit në mbështetje të së cilës është bërë financimi.” Të gjitha referencat tek “Projekti” gjatë gjithë këtyre kushteve të përgjithshme mendohen të jenë referenca në “Program”.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
 - 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)..... 1500**
 - 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600**
 - 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300**
 - 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500**

Botime të reja

- 1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
- 2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
- 3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
- 4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
- 5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000**
- 6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800**
- 7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500**
- 8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000**
- 9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500**

Hyri në shtyp më 5.7.2007
 Doli nga shtypi më 6.7.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
 Tiranë, 2007

Çmimi 28 lekë